

EDIOLA NASE

**PERIUDHA SHPREHËSE SI PËRFTESË RETORIKE NË ROMANIN
DASHURIA KUANTIKE E FILANIT E AUTORIT ADEM DEMA**

Kur shohin një tekst të shkruar, njerëzit e kuptojnë nëse është shkruar mirë. Sigurisht, ka mënyra të ndryshme të të shkruarit mirë, por brenda kufijve të gjerë shumica prej nesh e kuptojnë kur një paragraf ose trajtesë e bën punën e vet apo jo. Kjo ia vlen të theksohet, sepse, në qoftë se besojmë që gjykimet për një shkrim janë gjithmonë opinione personale, kjo do të thotë të ushqesh frymën e dështimit vetjak. Po të mos kishte standarde të prozës së mirë asgjë nuk do t'ia vlente të mësohej. Por standardet faktikisht ekzistojnë; ka proza që ia vlen t'i lexosh madje t'i rilexosh; gjithçka në sajë të një retorike mbreslënëse që tërheq lexuesit, ashtu siç rezulton të jetë sipas këtij studimi, edhe romani “Dashuria kuantike e Filanit”.

Sipas Thomas Kane: “*Shprehësi do të thotë që gjuha e përdorur të bëjë përshtypje, të ndikojë me efekt, të tërheqë vëmendjen, të përçojë diçka me forcë*”¹.

Në këtë këndvështrim, romani “Dashuria kuantike e Filanit” të tërheq së pari për vetë titullin e zgjedhur dhe domethënës që mban. Një titulli i zgjedhur përbëhet nga fjalë të qëllimshme e pikërisht kjo është një çështje e spikatur e retorikës së autorit, pasi, në këtë mënyrë, arrihet që të përçohet një domethënie e caktuar te lexuesi për t'u ngjallur atyre një përshtypje të veçantë në lidhje me fjalën dhe interpretimin e saj. Sipas akademikut Gjovalin Shkurtaj: “*Titulli është kartvizita e çdo teksti dhe pjesë përbërëse e tij, pra ndërtimi i tekstit nis qysh nga fillimi i tij*”².

Së pari: Në FSHS, fjala “kuant”, do të thotë sasia më e vogël e energjisë që mund të emetohet ose të përthithet nga lënda³. E, si për analogji, e tillë, platonike, e pamjaftueshme, dhe mikroskopike në lidhje me botën dhe idealet që e rrethonin, është edhe dashuria e Filanit, i cili arrin të vendosë idealet e shenjta për barazi, drejtësi e liri dhe mbi këtë ndjenjë hyjnore.

Dashuria që ai përjetonte më tepër se një lidhje fizike, ishte një lidhje shpirtërore që i kujtonte se në botën e tij fatkeqe bënte pjesë edhe ndjenja më fisnike e shpirtit njerëzor, ajo ndjenjë që i ushqente shpresën për një të ardhme të ëndërruar. Kështu, në letrën e fundit që i drejton së dashurës ai shprehet: “*Unë nuk e desha trupin tënd sepse unë nuk kam trup për trupin tënd. Unë e desha gabimisht vetëm shpirtin tënd duke menduar se ajo ishte gjysma që po*

¹Thomas S. Kane, *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë, CDE, 2010, f. 18.

²Gjovalin Shkurtaj, *Si të shkruajmë shqip*, Toena, 2008, f. 85.

³*Fjalor i Shqipërisë së Sotme*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002.

*kërkoja. Prandaj dhe dashurinë time ndaj teje e quajta kuantike dhe jo fizike*⁴; çka është perifrazim i shprehjes: “Gruaja është gjysma ime më e mirë”.

Së dyti: Anonimiteti spikat në përzgjedhjen e dy emrave me të cilat autori pagëzon dy personazhet kryesore. Ai qëllimisht nuk u kushton vëmendje të veçantë zgjedhjes së emrave dhe kështu e quan veten Filan Fistëku ndërsa të dashurën e tij e quan Dardhë, ndërkohë që të gjithë personazhet që e rrethojnë e kanë një emër të mirëfilltë.

Të gjitha këto lidhen me faktin se personazhi nuk ka nevojë për identifikim, ai është një idealist që nuk sprapset për asnjë çast nga kërkesat për çlirim dhe bashkim kombëtar, duke mbajtur një qëndrim parimor me këdo e kudo. Lidhur me këtë ai shprehet: “Unë nuk jam vetëm unë, por unë jam unë bashkë me të gjitha mbresat nga njerëzit që kam takuar dhe bashkë me ta kam ndarë përjetimet nëpër të cilat kemi kaluar”⁵

Po ashtu, autori duket se ushqen një dashuri të madhe dhe respekt për nënën e tij; është me interes, veçimi i një **paradoksi retorik** që ai përdor për të vlerësuar nënën e vet, kështu ai shprehet: “Nëna ime ishte analfabete, por edhe pedagoge e filozofe...”⁶

Gjatë leximit të romanit, e sidomos në letrat që Filani i shkruan Dardhës, apo në monologët e heshtur në ditët dhe netët e vështira të burgut, të bien në sy periudhat e shumta shprehëse si mjete të fuqishme të retorikës së autorit, disa prej të cilave po i paraqesim më poshtë:

Shpallja është një lloj periudhe, e cila përdoret në retorikë për t’i dhënë rëndësi një kumtimi, duke bërë një pohim paraparak, në të cilin lexuesit i vihet në dukje se më pas do të vijojë diçka e rëndësishme⁷.

Në këtë mënyrë, autori na paralajmëron që në fillim të letrës së fundit se Filani vendosi t’i japë lamtumirën së dashurës, prandaj në vend të shpalljes: “E dashura Dardhë!” (shpallje të cilën ai e ka përdorur në tetë letrat e mëparshme) ai tashmë zgjedh shpalljen: “E dashur mike!”, një mënyrë kjo, jo vetëm për t’i dhënë lamtumirën dashurisë së tij, por edhe për të treguar pamundësinë e ekzistencës së kësaj dashurie në rrethanat e vështira në të cilat gjendej protagonistin.

Si të tjera shpallje, veçojmë:

- *Gra! O motra! Të gjithë jemi në dorë të Zotit!* (f. 29), ose:
- *Hej, more, çka po kujtoni ju? Këtu është Shqipëri, more e nuk është Jugosllavi!... Kosova është djep i shqiptarizmit, more!...* (f. 67), ose:

⁴ Adem Dema, *Dashuria kuantike e Filanit*, Prishtinë, LSHK, 2012, f. 280.

⁵Po aty, f. 278.

⁶Adem Dema, *Dashuria kuantike e Filanit*, Prishtinë, LSHK, 2012, f. 85.

⁷ Thomas S. Kane, *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë, CDE, 2010, f. 419.

- *Hej more! Kur keni ardhur ju sllavët në Ballkan? Në shekullin e shtatë! Hej, more, kur keni ardhur prej përtej Karpateve, ju nuk e keni sjellur Kosovën në tarçuk, por Kosovën e keni gjetur këtu o okupatorë!* (f. 67)

- *Pritni t'ua them edhe vetëm një fjalë: Nëse qenka kështu si po thoni Ju, atëherë Kosova ka për t'jua hangër juve kokën! Do ta humbni edhe Jugosllavinë dhe në fund do të mbeteni edhe pa Kosovën!* (f. 153)

Ndërtimet paralele e të baraspeshuara si edhe vargëzimet stlistike i zgjerojnë marrëdhëniet në të cilat hyjnë fjalët dhe mundësojnë që të përftohet një ngjyrim kuptimor plotësues. Kjo është një vepër që i përket rrymës letrare të “përroit të ndërgjegjes”, ndaj autori rrëfen duke u nisur nga ajo që zhvillohet në mendjen e personazhit, ku ndjenjat dhe mendimet janë jashtë shtrëngesës logjike të ballafaqimit me realitetin, ato i përkasin një bote të kulluar idealesh. Në këtë mënyrë, vijueshmëria logjike zëvendësohet nga asosacionet dhe, si rrjedhim, përsëriten më shpesh fjalët, sintagmat apo dhe gjymtyrët e para të fjalive që vargëzohen njëra pas tjetrës⁸. Për shembull:

- *Të gjithë të respektonin, të gjithë të besonin, të gjithë e kishin plot gojën, Dardhë...* (f. 8), ose:

- *Rrebeshit të fortë i qëndrova vetëm, por bukurisë së fortë nuk po i qëndroja dot vetëm.* (f. 13), ose:

- *Fajin e kemi ne komunistët shqiptarë që komunistëve jugosllavë u besuam qorrazi. Fajin e kemi ne që kërkuam ndihmën e tyre. Fajin e kemi ne që i besuam idesë komuniste...* (f. 78), ose:

- *Po të ishe ishe ti skenariste, do të mund të shkruaje një skenar filmi. Po të ishe ti një dramaturge, do të mund të shkruaje një dramë. Po të ishe psikologe do të mund të shkruaje një sprovë interesante për psikologjinë e njerëzve të asaj kohe dhe për psikologjinë e të burgosurit.* (f. 86), ose:

- *Në syrin e tyre të majtë shihja pikëçuditësen e cila në “zum” shndërrohej në një heshtë me majë fort të mprehtë, kurse në syrin e tyre të djathtë shihja një pyetje e cila në “zum” shndërrohej në një litar varjeje...* (f. 106), ose:

- *Ata, kësaj i dite i thonë ditë e çlirimit të Prishtinës, kurse ne i thonim ditë e riokupimit.* (f. 113), ose:

- *Kadia të paditë, kadia të gjykon.* (f. 169), ose:

- *Mosbesimi i tyre shkakton mosbesimin tek ne. Urrejtja e tyre, shkakton urrjetjen tek ne. Shtypja e tyre shkakton rezistencën tek ne.* (f. 186), ose:

- *Unë nuk dëshiroja që ai të vdiste si njeri, para meje. Dëshiroja që ai sadopak të mbetë gjallë. Dëshiroja që ai të mos e humbiste besimin te të gjithë njerëzit. Dëshiroja që ai të bindej...* (f. 196), ose:

⁸ Po aty, f. 371.

- *Shumë njerëz, shumë mendime, shumë qëndrime, shumë rrëfime. Me të gjithë mundohesha të kaloja mirë, përveç atyre që rrinin me çetnikët.* (f. 262), ose:

- *Ti, as mos rrafsh e as mos u vrafsh. Kurse unë ku rrafsha mos u vrafsha.* (f. 282)

Nga ana tjetër, **kiazma** në retorikë (me prejardhje nga gr. *chiasmós*⁹, është vendosja e diçkaje në trajtën e shenjës X, pra e kryqëzuar) është ajo lloj periudhe që ndërtohet si rezultat i përmbysjes së rendit në periudhën e baraspeshuar¹⁰; e cila gjithashtu është një lojë gjuhësore me shumë efekt e përdorur nga autori. Shembuj:

- *Dhe, si e tillë, ajo më takon dhe, si i këtillë edhe unë i takoj asaj.* (f. 14), ose:

- *Nëse do trupin, harroje shpirtin! Nëse do shpirtin harroje trupin!* (f. 127), ose:

- *Dhe durimi shkakton mërzinë e mërzia të han shëndetin* (f. 229)

Fragmentimi, po ashtu, është një tjetër lloj i periudhës shprehëse në romanin e Adem Demaçit, që brenda një tabloje kuptimore e ndan rrjedhën e fjalëve aty ku gramatika do të kërkonte një vazhdim të pandërprerë. Kështu, fjalitë e shkurtra, të drejtpërdrejta bëjnë përshtypje si copa të pranëvëna, brenda së njëjtës tabloje kuptimore¹¹. Për shembull:

- *U lodha duke u durur sa nga një mur në tjetri. U ula. Si ndryshe, pos këmbëkryq. Parketi i fortë dhe akull i ftohtë...*(f. 123), ose:

- *U ngrita disi në këmbë. Ishte zdritur. Rrapllima vazhdonte dhe ajo i afrohej dhomës sime. Vura vesh. Sikur një garuzhdë mbushej e zbrazej. Kur kazani u ndal para derës sime thashë se do të bë bëhej diçka. Por nuk u bë asgjë.* (f. 125), ose:

- *Kaloi dita. Kaloi darka. Kaloi edhe një copë e bukur e madhe e pasdarkës.* (f. 143), ose:

- *U turpërova. Qenka shkruar të vdes nga bostanie, hajt! M'u ndal mendja dhe m'u shtang trupi. Vetëm dija të turpërohesha. Asgjë tjetër. U pajtova. Prisja vdekejn....* (f. 253)

Po kështu **periudha periodike**, haset shpesh në vepër. Ajo fillon me pjesën e nënrenditur dhe mbyllet me pjesën e pavarur, ndërkohë që kjo e fundit përfaqëson edhe mendimin kryesor të fjalisë¹². Si rezultat i një ndërtimi të tillë lexuesi detyrohet të mbajë vëmendjen pezull deri sa të vijë te pjesa ku do të rrokë të plotë idenë e autorit.

⁹ M. Bejta et al, *Fjalor i fjalëve të huaja*, 1988, Prishtinë.

¹⁰ Thomas S. Kane, *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë, CDE, 2010, f. 421.

¹¹ Po aty, f. 421.

¹² Thomas S. Kane, *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë, CDE, 2010, f. 427.

Për shembull:

- *Mirëpo edhe pse e bardha dhe e zeza, e ëmbla dhe e hidhura, e mira dhe e keqja, trimëria e qyqarllëku, lindja e vdekja, që janë pjesë të pandashme të jetës, sa fort ato dallojnë njëra pas tjetrës.* (f. 110), ose:

- *Shiko, ju shkrimtarët e keni intuitën më të zhvilluar dhe mund të jetë se Cvija, si një malazeze që është edhe mund të jetë me ne, mirëpo sido që të jetë, nëse është thënë të kalosh nëpër atë rrugë, do të kalosh.* (f. 117), ose:

- *Pastaj pas Luftës së Dytë Botërore, pas luftës antifashiste që e bëme serbë e shqiptarë bashkë edhe pse ekzistonte Rezoluta e Bujanit e cila u premtonte shqipatrëve, pas mbarimit të luftës dhe pas fitores mbi nazifashizmin të drejtën mbi vetvendosje, deri në shkëputje, serbia prapë, nuk hoqi dorë nga Kosova* (f. 147), ose:

- *Kur, herët në mëngjes, më futën në xhip për në Gjyqin e Qarkut, në kokën time që më ishte bërë si daulle nga pagjumësia, kisha vetëm një mendim: sulm e asgjë tjetër!* (f. 207).

Gjithashtu **pyetja retorike** është nga tropet më shprehëse që përdoren për efekte emocionale. Në këto raste kemi ndërthurje të pranimit të tërthortë të një fakti me pakënaqësinë përkundrejt tij, me ankimin apo qortimin¹³. Në një roman “personazhi”, ashtu siç mund të cilësohet “Dashuria kuantike e Filanit”, pyetjet retorike japin hapur qëndrimin autorit në lidhje me jetën, dashurinë, lirinë, respektin, marrëdhëniet njerëzore dhe, nëpërmjet këtyre qëndrimeve, ai arrin të shprehë pikpamjet e veta në lidhje me to:

- *A nuk jam edhe vetë pjesë e gjithësisë kuantike?* (f. 14), ose:

- *A nuk është edhe Dardha veçse një lëmsh kuantik sikundër jam edhe vetë?* (f. 14), ose:

- *Çfarë na pengon që të dashurohemi nëse harrojmë që jemi qenie fizike?* (f. 14), ose:

- *Harrove krimet e tyre? Harrove krimin e Tivarit? Harrove krimet e Shalës të Ferizajt, të Gjilanit?! Harrove “strelishten” e Prishtinës? Harrove gjykimet Ali Shukriut? Harrove gratë e reja, mocanikët e tu që u rritën jetimë? Harrove shpërnguljen e dhunshme që s’u ndal kurrë?* (vazhdon gati një faqe, f. 106-107), ose:

- *Dhembje e madhe, dhembje e pafund është kur digjet njeriu, mirëpo, çfarë kuptimi ka jeta pa liri?* (f. 183)

Nocionet e **ritmit dhe rimës**, të marra nga folklori i japin periudhës një fuqi shprehëse plotësuese¹⁴, të cilën autori ka ditur ta shfrytëzojë më së miri në prozën e tij:

¹³Thomas S. Kane, *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë, CDE, 2010, f. 429.

¹⁴Po aty, f. 429.

• *Si thotë ajo fjala popullore, “një pëllëmbë njeri e shtatë pëllëmbë seri”* (f. 53), ose:

• *Ata që i kuptojnë edhe i pranojnë këto paradokse si normale, ata janë të lumtur. Unë, më në fund i kuptova dhe i pranova, prandaj, më në fund, jam i lumtur... Vallë, do t'i mësoh, do t'i kuptosh e do t'i pranosh edhe ti? Sa fort kisha pasur dëshirë që edhe ti, t'i kuptosh e t'i pranosh! Sepse të dua fort e prandaj kasha pasur dëshirë që edhe ti të jeshë e lumtur...* (f. 110), ose:

• *Slivnicën për Bregalnicën! Kumanovën për Kosovën!* (f. 174), ose:

• *Askush nuk di se ka mundime e gjëmë pa kaluar Shqipërinë këmbë* (f. 174), ose:

• *Çeli lype, çeli gjete* (f. 235), ose:

• *Çfarë ka në gushë, atë e qet përfushë!* (f. 272) ose:

Polisindet (gr. *poly* + *syndeton*; shumë lidhëza - grumbullimi i lidhëzave në fjali)¹⁵. Ndërtimet me polisindet janë dukuri e vargëzimeve, e enumeracioneve, domethënë e listave të gjymtyrëve. Në ndërtime të tilla merr peshë secila gjymtyrë më vete. Ndërkaq vihet në pah lidhja e anëve të ndryshme të paraqitjes, ngulmohet tek mendimi i përbashkët dhe në disa raste qëllimisht ngadalësohet ligjëratat¹⁶.

Për shembull:

• *E, ti po deshe shtangu nga të ftohtët, po deshe çmenduri, po munde qëndro*” (f. 124), ose:

• *As rrëfimet e përsëritura me qindra herë të nënës Nazife, as mësimet e mësueses Vezire, as rrahja e Abejit nga ana e çetikut – partizan, as ligjëratat e fshehta të mësuesit Kolë, as ligjëratat e fjalët besnike të profesor Zekeria Rexhës, as...* (vazhdon gati një faqe) (f. 128)

• *Këtë logjikë nuk e kap kurrfarë defteri. As Tivrati, as Zeburi, as Bibla, as Kur’ani, as shkenca, as letërsia jote!* (f. 135), ose:

• *Në dyshen nuk kasha mundësi as të merresha me anlizat e mia, as të fishkëlloja këngët e mia, as të merresha me ecejaket e mia* (f. 229), ose:

Gjithashtu në vepër dallojmë përdorimin e **neologjizmave**¹⁷ (gr. *neos* + *logos*; fjalë e re - fjalë ose shprehje që ka hyrë rishtazi në gjuhë për të shënuar një send a një dukuri të re dhe që ende ndihet si e tillë). Si fjalë të rralla, neologjizmat tërheqin vëmendjen, bien në sy dhe nguliten në mendje¹⁸. Pasi i kanë pëlqyer shkrintarit si përftesa në përputhje me ndërtimin artistik të tekstit të vet, ato ngjallin kureshtje edhe te lexuesi, i cili e ndien se çfarë mundësish krijuese ka gjuha shqipe. Për shembull:

¹⁵ M. Bejta et al, *Fjalor i fjalëve të huaja*, 1988, Prishtinë.

¹⁶ Thomas S. Kane, *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë, CDE, 2010, f. 442.

¹⁷ M. Bejta et al., *Fjalor i fjalëve të huaja*, 1988, Prishtinë.

¹⁸ Thomas S. Kane, *Si të shkruajmë shqip*, Tiranë, CDE, 2010, f. 566.

- *Qoftë ai më i madhi, më i forti, çdo njeri ka nevojë për një **shtrojerë** ku do të ketë mundësi, të strehoet, të pushojë, të ngrohet e të gjejë qetësinë e vet shpirtërore nga stuhitë e pafund të jetës së kaluar, të jetës së sotme dhe të marrë forcë për stuhitë e reja që e presin.* (f. 8)

- *Enver Tali, një djalosh nga Gjilani, me ballë të ngushtë mbi të cilin binin flokët e **paurta**.* (f. 71), ose:

- *.. mbi një mur qëndronte **vëzhgimorja**, me dritare të mëdha në të katër anët.* (f. 122), ose:

- *Por, kësaj here midis rrapllimësh ishte një **ndërmjetëz** kohore...* (f. 125), ose:

- *Parliqi mori **dëgjojsen** dhe pasi që dëgjoi zërin e folësit u përgjigj.* (f. 171), ose:

Tautologjia¹⁹ (gr. *tauto* + *logos*; fjalë e njëjtë, përsëritje zakonisht pa nevojë e po atij mendimi e po asaj gjëje a ideje me fjalë të tjera të afërta nga kuptimi, përsëritja e asaj që është thënë jo me të njëjtat fjalë). Mjeshtëria e përdorimit të saj nga autori e ka kthyer përsëritjen nga një të metë të të shkruarit në një nga përftesat më të pasura për të rritur shprehësinë e fjalës dhe të mendimit. Për shembull:

- *Pakngapak e gjithnjë e më shpejt çdo gjë fizike filloi të **shjprishej e të shkrihej**, të **avullohej e të zhbëhej**.* (f. 12), ose:

- *Dhe Universi herët a vonë të **ndëshkon e të dënon**.* (f. 18), ose:

- E kam ditur unë se ky është një **pizeveng**, se ky është një **harbut**, se ky është një **tradhëtar** i rrugës së Leninit, se ky është një **jezuit** i maskuar brenda partisë bolshevike! (f. 65), ose:

- Ne që kishim mbetur ishim **vllazëruar** e ishim **mishëruar** aq shumë midis nesh sa që ishim bërë si një familje. (f. 68), ose:

- U lëshova në disa **përsiatje e mendime** fort serioze (f. 105), ose:

- Këta e kanë sjellur këtu më shumë për të **kontrolluar** e për të **nuhatur**. (f. 114), ose:

- *Unë u gjeta fare **i trulluar dhe i hutuar**.* (f. 151), ose:

- *Brenda meje tani nuk është **ai i mjeri, i shkreti, i gjori, ai vehtiaku** që mendonte vetëm për trupin e vet.* (f. 156), ose:

- Tani isha plotësisht i kthjelluar dhe nuk e kasha më frikën e vetvetes e cila m'ë **ngatërronte e mjegullonte** mendimet. (f. 183)

Përfundime

Shkrimtari Adem Demaçi, në veprën e tij “*Dashuria kuantike e Filanit*”, përmes një retorike mbreslënëse ka sintetizuar me sukses një pjesë të filozofisë së tij jetësore në kërkim të së vërtetës, në kërkim të lirisë, barazisë dhe drejtësisë. Qëndrimi tij i patundur e vendos atë në pedestalin e idealizmit,

¹⁹M. Bejta et al, *Fjalor i fjalëve të huaja*, 1988, Prishtinë.

duke e bërë një shembull frymëzimi të një filozofie iluministe-idealiste dhe humaniste njëkohësisht, përderisa ruan në vetevete freskinë e shpirtit njerëzor dhe dashurinë për jetën e gjithçka që lidhet me të.

Përgjithësisht, mund të shprehem, se mundësitë gjuhësore janë kaq të mëdha dhe të thella, saqë ne asnjëherë nuk arrijmë ta zotërojmë të shkruarin dhe të shprehurin plotësisht dhe përfundimisht; ndaj ky punim kishte për qëllim të na njihte përmes shembujve konkretë me rëndësinë e retorikës përsa i përket përdorimit të periudhës shprehëse, si mjet i fuqishëm i të shprehurit mbreslënës, në emër të një “proze të mirë”.

BIBLIOGRAFI

Adem Dema, *Dashuria kuantike e Filanit*, Prishtinë, LSHK, 2012.

Fjalor i Shqipes së Sotme, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2002.

Gjovalin Shkurtaj, *Si të shkruajmë shqip*, Toena, 2008.

M. Bejta, L. Mulaku, M. Bardhi, Sh. Islamaj, I. Goçi, Q. Murati, A. Zajmi, *Fjalor i fjalëve të huaja*, Prishtinë, 1988.

Thomas S. Kane, *Si të shkruajmë shqip (Manual i Oksfordit për të shkruarin dhe retorikën, i përshtatur për shqipen)*, Tiranë, CDE, 2010.

EMA KRISTO, JONIDA XHYRA-ENTORF

SPECIFIKAT E PËRKTHIMIT LETRAR

Fjalë çelës: Përkthim letrar, teksti origjinal, format e përkthimit, riprodhimi i tekstit.

Njohuri të kufizuara në gjuhë të huaja shpesh na pengojnë që të lexojmë vepra letrare në gjuhën origjinale prandaj jo rrallë ne i drejtohem përkthimit të një vepre. Natyrisht që lexuesi gëzohet për këtë fakt por nga ana tjetër ai vë në pikëpyetje cilësinë e përkthimit letrar. Jo gjithmonë është e mundur që të gjitha mesazhet që dëshiron të shprehë autori transmetohen nga përkthyesi në mënyrë të tillë që të ruhet efektshmëria e tekstit. Elementet gjuhësore dhe estetike të tekstit që janë specifike për një kulturë të caktuar shpesh nuk lejojnë që një tekst në gjuhë të huaj të përkthehet në të njëjtin nivel gjuhësor.

Transmetimi i karakteristikave të veçanta të teksteve letrare si *ritmi, tingulli, format krijuese* dhe *shmangiet nga norma* në një gjuhë tjetër kërkon më shumë se sa vetëm njohuri gjuhësore.

Prandaj edhe përkthimi letrar ka një rol tejet të rëndësishëm dhe të veçantë, krahas llojeve të tjera të përkthimit.

Kjo fushë e veçantë e përkthimit është mjaft e gjerë prandaj e shohim të udhës të përkufizojmë fillimisht përkthimin letrar. Më pas do të diskutohen disa teori mbi përkthimin letrar si dhe problematikat me të cilat përballet përkthyesi letrar gjatë përkthimit.

Me interes këtu është çështja se sa besnik duhet t'i mbetet përkthyesi tekstit origjinal. Sa i lejohet përkthyesit ta ndryshojë një tekst? Ku është kufiri të cilin ai nuk lejohet ta kalojë? Nën cilën perspektivë e shikon ai tekstin?

Në librin e tij “Weltliteratur in deutscher Übersetzung” (Letërsia botërore në përkthimet gjermane) Stackelberg¹ i përkushtohet temës së përputhjes stilistikore midis origjinalit dhe tekstit të përkthyer dhe krahason me njëri-tjetrin variante të ndryshme përkthimi. Romani “Madam Bovari” i Gustav Flober-it p.sh. është përkthyer në gjuhën gjermane katër herë dhe secili përkthim përfaqëson një variant të ri.

32 përthyes të njohur çek kanë përkthyer poezitë e Christian Morgenstern. Rezultati: Çdo përkthim paraqet një variant i ri. I njëjti fakt konstatohet edhe kur krahasohen dy përkthimet në shqip të romanit “Vuajtjet e djaloshit Verter” të Johann Wolfgang Goethe.

Këto janë shembuj të cilët tregojnë se gjatë procesit të përkthimit teksti origjinal mund të ndryshohet në mënyra të ndryshme.

¹ Stackelberg, 1978, f. 18.

Përkthimi i teksteve letrare

Përkthimi letrar nënkupton përkthimin e një teksti që konsiderohet letrar në kulturën burimore (në gjuhën origjinale) dhe përputhet me kërkesat e një teksti letrar në kulturën marrëse (në gjuhën e përkthyer)².

Ndryshimet midis tekstit origjinal dhe përkthimit të një teksti letrar përbëjnë një nga çështjet kryesore të këtij artikulli. Këto ndryshime janë rrjedhojë e procesit të përkthimit, prandaj e shohim të udhës që këtu të tematizojmë përkthimin letrar para se të fillojmë më hollësisht analizën e ndryshimeve që konstatohen midis origjinalit dhe përkthimit.

Veçoritë e teksteve letrare – veçoritë e përkthimit letrar

Veçoritë e teksteve letrare si ritmi, format krijuese si dhe shmangiet nga norma e kthejnë një tekst në një “vepër arti”. Që këto veçori të përkthehen në një gjuhë tjetër, nuk mjafton vetëm kompetenca gjuhësore. Prandaj përkthimi letrar – krahas përkthimeve të llojeve të tjera – merr një rol të veçantë. Shpesh për përkthimin letrar hasim edhe termat *përkthim artistik* apo *përkthim estetik*³. Çështja me të cilën merren teoricienët ka të bëjë me faktin se sa besnikë duhet t’i mbetemi tekstit origjinal në përkthim. Në lidhje me këtë çështje ka pikëpamje të ndryshme. Këtu po paraqesim dy teori në lidhje me përkthimin letrar: *Teoria e riprodhimit të tekstit* e Levy-t si dhe *Teoria e manipulimit të tekstit* e Hermans, për të bërë më të qartë se sa e rëndësishme është ‘besnikëria’ ndaj tekstit origjinal.

Levy formuloi rreth fundit të viteve 60-të në librin e tij “Literarisches Übersetzen” (Përkthimi letrar) (Levy 1969) një teori, e cila është një ndër më të cituarat në botimet mbi teorinë e përkthimit.

Sipas kësaj teorie ekzistojnë dy norma të përkthimit letrar: “bukuria/eleganca letrare” dhe “besnikëria ndaj tekstit”. Të dyja janë të padiskutueshme në procesin e përkthimit. Qëllimi i çdo procesi përkthimi është sipas kësaj teorie “vepra origjinale (mesazhi i saj) të ruhet, të transmetohet por jo duke krijuar një vepër të re, qëllimi i përkthimit në këtë rast është riprodhimi⁴.

Për Levyn në këtë rast nuk ka rëndësi përputhshmëria me realitetin, pra me origjinalin, por më shumë rëndësi ka fakti që përkthimi t’i duket lexuesit si i vërtetë. Përkthimi mund t’i ngjasojë deri në një farë mase origjinalit, por ai duhet të veprojë tek lexuesi me të njëjtin intensitet si origjinali.

Ndërkohë që Levy këmbëngul për një rihënie besnike të origjinalit, Hermans⁵ përfaqëson pikëpamjen që ndryshimet në tekst janë të padiskutueshme dhe duhen pranuar kur bëhet fjalë për përkthim të një teksti letrar. Përpjekja për një ekuivalencë të plotë në të gjitha rrafshet e tekstit është

² Toury, 1995, f. 171.

³ Kohlmayer/ Pöckl, 2004, f. 31.

⁴ Levy, 1969, f. 65.

⁵ Hermans, 1985, f. 7.

sipas tij një përpjekje utopike: “In such circumstances, any attempt to tamper with a literary text by rendering in into another language must be condemned as a foolhardy and barely permissible undertaking, doomed from the start and to be judged, at best, in terms of relative fidelity, and at worst as outright sacrilege.”⁶. Sipas Hermans teksti mund të manipulohet, duke ruajtur gjithsesi qëllimin kryesor.

Megjithëse këto teori nisen nga pikëpamje të ndryshme - njëra orientohet ndaj tekstit, tjetra ndaj lexuesit - ato kanë të përbashkët qëllimin që gjatë procesit të përkthimit të arrihet ngjashmëri në transmetim midis tekstit origjinal dhe atij të përkthyer.

Gjithsesi kërkesa për të arritur efektin e duhur nëpërmjet përkthimit në praktikë është e vështirë të realizohet. Kjo për faktin se nuk ekziston ndonjë model përkthimi ndaj të cilit mund të orientohen përkthyesit. Kjo do të thotë që përkthyesi punon në mënyrë subjektive dhe bën një riprodhim subjektiv të tekstit. Gjithashtu përkthyesi gjendet edhe para problemeve të tjera të përkthimit, të cilat kanë të bëjnë edhe me elemente të tjera komplekse të teksteve.

Problematika dhe mundësitë e përkthimit

Faktin që përkthimi i një teksti letrar paraqet një proces të vështirë që ngërthen brenda vetes probleme të shumta e tregojnë edhe botimet e shumta në këtë fushë në gjuhë të ndryshme, si p.sh. *Die ästhetischen Probleme des Übersetzens* (problemet estetike të përkthimit) (Levy 1969), *Das Problem der Übersetzung* (Problemi i përkthimit) (Abel 1999), *Fremdheit als Problem und Programm* (E huaja si problem dhe program) Huntermann/ Rühling 1997), *Këshilla një përkthyesi të ri* (Tupja 2000), Cultural implications for translation (James 2002) etj., etj.

Përkthimi i veprave letrare mund të shihet si një veprimtari problematike. Një pjesë të mirë të kësaj veprimtarie e përbën kërkimi i sinonimeve të plota, gjë që jo gjithmonë është e mundur. Në shumicën e rasteve një fjalë e caktuar mund të zëvendësohet nëpërmjet një sinonimi të pjesshëm, i cili vetëm në mënyrë të pjesshme mund të paraqesë të njëjtin kuptim.

Por ekuivalenca nuk mund të reduktohet vetëm tek leksiku. Mospërputhja e gjuhëve shkakton probleme në të gjitha rrafshet tekstore, të cilat sipas Stolze mund të renditen në këtë mënyrë⁷:

- Probleme të cilat i referohen mjeteve shprehëse dhe stilistikore të cilat nuk ekzistojnë në të gjitha gjuhët
- Probleme pragmatike të cilat kanë të bëjnë p.sh me përkthimet e citateve, metaforave, shprehjeve deiktike
- Probleme kulturore

⁶ Ibid.

⁷ Stolze, 2001, f. 214.

- Probleme të përkthimit që kanë të bëjnë me konotacionet, fjalëformimin etj.

Është sigurisht tejet e vështirë që të gjitha këto aspekte të tekstit të transmetohen në një gjuhë tjetër. Mënyra se si zgjidhet ky problem varet në një masë të konsiderueshme nga ndjenja letrare e secilit përkthyes, nga aftësitë e tij për të transmetuar në mënyrën e duhur cilësitë letrare të një teksti.⁸

Sipas pikëpamjes së Levy-t përkthyesit përdorin shpesh një koncept të përgjithshëm në vend të një koncepti konkret. Ose një fjalë neutrale nga pikëpamja stilistikore në vend të një fjale me ngjyrim emocional. Ata përdorin vetëm në mënyrë sporadike sinonime për të pasur variacion në shprehje.

Nga ana tjetër përkthyesi konfrontohet shpesh me çështjen se cilat tipare në tekstin e përkthyer mund dhe duhet të ruhen⁹. Qëllimi është gjithmonë që teksti i përkthyer të jetë i kuptueshëm. Shpesh përkthyesi ka mundësi alternative të shumta të të shprehurit në gjuhën e përkthimit për një fjalë të gjuhës që po përkthehet (të origjinalit)¹⁰. Në këtë rast ai duhet të vendosë në bazë të mendimit të tij subjektiv, se cilën fjalë dhe kuptim konotativ do të zgjedhë¹¹.

Problematika e ekuivalencës së fjalëve emocionale (që mbartin emocione) konkretizohet me anë të një shembulli të Hermans (2004, 36): Fjala italiane *addio* përkthehet në gjuhën gjermane me fjalën *tschüss*. Por fjala italiane përmban në vetvete besim e simpati ndaj personit që përshëndetet, gjë që nuk mund të konstatohet në fjalën gjermane. Pra ajo nuk është plotësisht ekuivalente me fjalën korresponduese në gjuhën gjermane. Nëse në një gjuhë nuk gjendet fjala që mbart të njëjtin emocionalitet si në origjinal, atëherë ajo zëvendësohet me një fjalë më të përgjithshme që nuk mbart patjetër emocione.

Kompromisi është i padiskutueshëm gjatë procesit të përkthimit. Megjithëse dihet se ruajtja e të gjitha vlerave të tekstit origjinal nuk mund të arrihen kurrë në përkthim, në teori kërkohet gjithmonë ekuivalencë midis tekstit origjinal dhe atij të përkthyer. Kjo kërkesë për ekuivalencë është shumë e diskutueshme pasi përkthyesi në tekstin e përkthyer nuk mund të ofrojë përputhshmërisht të njëjtën gjë si autori i tekstit origjinal për aq kohë sa edhe receptuesit (marrësit) e tekstit kanë pritshmëri të tjera gjatë të lexuarit në bazë të përkatësisë së tyre kulturore¹².

Pra duket qartë se kërkesa për një ekuivalencë të barabartë e të gjitha komponentëve (stilistikorë, pragmatikë, kulturorë dhe emocionalë) duke marrë parasysh edhe ndryshimet kulturore të lexuesve nuk mund të realizohet lehtë.

⁸ Ibid.

⁹ Abel, 1999, f. 15.

¹⁰ Macheiner, 2004, f. 11.

¹¹ Ibid.

¹² Reiss, 1984, f. 123.

Specifikat e përkthimit letrar

Gjatë procesit të përkthimit ka një humbje të pashmangshme informacioni. Reis¹³ mendon se nuk mund të ketë një ekuivalencë të plotë midis tekstit origjinal dhe atij të përkthyer.

Përkthyesi duhet të ruajë ekuilibrin midis strukturës së tekstit origjinal dhe stilit vetjak të të shprehurit. Sipas Levy “lexuesi e di që nuk ka në dorë origjinalin por përkthimin e tij, por ai kërkon që përkthimi të ruajë cilësitë e origjinalit.”¹⁴

Përkthyesi duhet t’i nënshtrohet rregullave të veçanta të përkthimit, megjithatë si disponon një farë lirie artistike që i lejon atij të transmetojë formën e përmbajtjes në mënyrën e duhur nga origjinali në gjuhën e tij.

Për përkthyesit e teksteve letrare një rol të rëndësishëm luajnë edhe komponentët emocionalë. Teksti letrar kërkon më shumë potencial interpretimi se sa llojet e tjera të teksteve. Ndryshimi më i madh midis origjinalit dhe përkthimit të tij, është se teksti origjinal është një unikat. Ai është krijuar në një kohë dhe vend të caktuar, me një funksion të caktuar për një rreth të përcaktuar lexuesish.

Prandaj në shumicën e rasteve është e vështirë për përkthyesin që të realizojë të gjitha pritshmëritë që kërkohen prej tij në lidhje me përkthimin dhe njëkohësisht të ruajë stilin e autorit origjinal.

Përfundime

Përkthimi letrar shihet si një gjini e veçantë. Gjithmonë e më shumë diskutohet çështja nëse përkthimi letrar është objekt i linguistikës (gjuhësisë) apo i letërsisë. Me zbatimin e metodave gjuhësore në disiplinën e letërsisë kjo çështje ka marrë dimensione të reja.

Nisur nga këto parashtrime ne konstatojmë se përkthimi letrar në radhë të parë është një proces gjuhësor, produkti i të cilit – teksti i përkthyer – duhet të përmbajë veçori letrare. Ky konstatim mbështetet në një aspekt të rëndësishëm, pikërisht në çështjen e strategjisë së përkthimit. Përkthyesi gjatë procesit të përkthimit letrar gjendet gjithmonë përpara pyetjes: Me cilin qëllim do të përkthej: Me qëllimin për të ruajtur besnikërinë gjuhësore apo bukurinë (elegancën) letrare? Përgjigja për këtë pyetje i lihet në dorë vetë përkthyesit i cili është i lirë të vendosë për një strategji të caktuar përkthimi. Nëse ai dëshiron t’i mbetet besnik tekstit origjinal në pikëpamje gjuhësore, të përmbajtjes dhe semantike atëherë ai zgjedh një tip të hapur të përkthimit (riprodhimin). Nëse ai i jep më shumë rëndësi bukurisë letrare atëherë ai ka vendosur për një tip të mbyllur apo “të mbuluar” të përkthimit (manipulimin).

BiBLOGRAFI

G. Toury (1995), *Descriptive Translation Studies and Beyond*, Benjamins.

¹³ Ibid.

¹⁴ Levy, 1969, f. 31.

- Günter Abel (1999), *Übersetzung als Interpretation*. Narr Verlag. Tübingen.
- Jiri Levy (1969), *Die literarische Übersetzung. Theorie einer Kunstgattung*. Athenäum. Frankfurt am Main.
- Judith Macheiner (2004), *Übersetzen. Ein Vademecum*. Piper Verlag. München.
- Jürgen Stackelberg (1978), *Weltliteratur in deutscher Übersetzung*. Fink Verlag, München.
- Katharina Reiss (1984), *Grundlegung einer allgemeinen Translationstheorie*. Niemeyer. Linguistische Arbeiten. Tübingen.
- Radegundis Stolze (2001), *Übersetzungstheorien. Eine Einführung*. Tübingen. Narr.
- Rainer Kohlmayer & Wolfgang Pöckl (2004), *Übersetzungswissenschaft, Dolmetschwissenschaft. Wege in eine neue Disziplin*. Edition Praesens. Wien.
- Theo Hermans (1985), *The Manipulation of literature*. Studies in literary translation. St. Martin Press. New York.